

MUHARREM GASHI

**E FOLMJA E QYTETIT TË PRIZRENIT DHE E RRETHINËS SË TIJ
NË KRAHASIM ME HARTAT E ADGJSH-SË**

Abstrakt:

Fjalët çelës: Turreci, Lorëza, Trinci, Griza. Pikthi, Guja, Mullëza, Femëza, shkund, ngjesh, mjaltë, mjekërr, kërcell

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe është ndër veprat më të rëndësishmet të gjuhësisë në përgjithësi, ndërsa në mënyrë të veçantë për sferën e dialektologjisë. Kjo vepër shquan parimet më të arrira të gjeografisë gjuhësore, larminë dhe gërshetimet e njësive të ndryshme dialektore të shqipes. Ky vëllim që ka për projekt veçoritë dialektore dhe shtrirjen e tyre, shteron anketat, përshkrimet, vëzhgimet, skicat dhe monografitë dialektologjike në gjithë territorin e shqipfoljes. Kështu ndriçohet historia dhe proceset që u zhvilluan në të kaluarën, me të cilën kapet ngjyrimi më i saktë i pasqyrimin, lëvizjeve dhe kontakteve ndër njësi gjuhësore të shqipes. Në prizmin e këtij interesi të rëndësishëm të studimeve dialektologjike kjo u bë nëpërmjet pyetjeve dhe nënpyetjeve: 260 me 40 në leksik, 65 me 107 në fonetikë, 80 me 80 në morfologji, pastaj formimin e fjalëve dhe sintaksën e të folmeve të arealeve. Në këtë aspekt edhe të folmet e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës historikisht dëshmojnë rëndësinë e këtij rajoni, madje edhe si rrugë kalimtare që e ka lidhur brendësinë e Gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Derisa “Meshari” i Gjon Buzukut është përfaqësim i përgjithshëm i kulturës dhe gjuhës shqipe, “Çeta e profetëve” e P. Bogdanit është vëllim i përveçëm i të folmeve të Prizrenit me rrethinë. Padyshim duke pasur në konsideratë edhe gjithë rëndësinë dhe vlerën e përfaqësimit në letërsinë tonë të vjetër, si: “...*të jetë ëndë forë së ndritshmit gjakut së Davidit, 8; athue zogu gjithë i ngjuem, 68; pse asht i kuq petku yt...*”. Kjo trashëgimi e pasur e me vlera leksikore të frazeologjisë u mblodh e tëra në shërbim të ndërtimit të Gjuhës shqipe, po kështu edhe ky krahasim me vetë ADGJSH-në, përkatësisht me pyetësin e kësaj të arriture të së sotmes shqipe është në këtë funksion. Në këtë hulli të përimitimit, radhitjet e dyqind e pesëdhjetë e nëntë njësive leksikore mëtojnë edhe më ta pasurojë larminë. Është e pamundur që në këtë trajtesë t’u referohemi të gjitha njësive leksikore, aq më tepër pasqyrimin me shembuj që të reflektojmë dëshminë e përdorimit në të folmet që i kemi në trajtim: në pikën 146-të, daljes së diellit, që në variantin standard është: *lind*, në këto të folme përdoret: */Ka le dilli./*, ndërsa për perëndimin e diellit: */Ka praru dilli/*. Në këtë aspekt shtojmë vetëm laryshinë e emërtimeve të zogjve, si për

shembull: TURREC-I: /Zog që vjen në pranverë dhe knon *turr-turr*, vjen me qyqen e shkon gati në gjysmë të pranverës!//; LORËZ,-A: /Shpend i madh gati sa turreci dhe knon: *hej-haj-haj-hej*, gati si njeri!//; TRINC-I: / Zog shumë i vogël//; GRIZË,-A: /Një lloj fllanze e malit, gati si pllumb mali!// etj.

Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe është vepër madhore, ndër veprat më të rëndësishmet të gjuhësisë në përgjithësi, ndërsa në mënyrë të veçantë për dialektologjinë shqiptare. Kjo vepër me parime më të arrira të gjeografisë gjuhësore shtron gërshetimet ndërmjet njësive të ndryshme dialektore të shqipes: nga anketat, përshkrimet, vëzhgimet, skicat dhe monografite dialektologjike të të dy fazave të zhvillimit të dialektologjisë sonë. Kjo veprimtari shumëvjeçare shkencore e iniciuar që në vitet 30 e 40 nga E. Çabej, solli risi të rëndësishme për zgjerimin e thellimin e njohurive ashtu edhe për metodën e hulumtimeve. Në këtë aspekt u përmtuan studimet e njësive dialektore të botuara në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e Greqi, në mënyrë që të ndriçohet historia dhe proceset e lëvizjeve të dukurive që u zhvilluan. Kjo u bë nëpërmjet pyetjeve dhe nënpyetjeve: 260 me 40 në leksik, 65 me 107 në fonetikë, 80 me 80 për morfologjinë, formimin e fjalëve dhe sintaksën¹ që i karakterizojnë raportet e varietetit standard të gjuhës sonë përball dialekteve, të folmeve dhe shtrirjeve të elementeve të tyre. Duke e bërë edhe më të njohur gjendjen e sotme të dialekteve dhe të folmeve tona, "Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe" ka interes jo vetëm për gjuhësinë e historinë shqiptare, por edhe për studime të tjera. Në radhë të parë për studimet ballkanistike, për problemet teorike të përgjithshme, siç janë ai i kontakteve etj. Ndihtesë të veçantë i sjell historisë së gjuhëve në raportet kufitare, nga të cilat të folmet shqipe, kryesisht anësore, ruajnë gjurmë fazash të moçme, të zhdukura në ato treva². Gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm, krahas mbledhjes së materialit dialektor, nëpërmjet skicave përshkruese e monografive të të folmeve u pasqyruan dallime dhe tipare të përbashkëta me vlera dialektologjike. Në këtë hulli të folmet e arealeve të Prizrenit me rrethinë paraqesin interes të rëndësishëm për studimet dialektologjike dhe për trajtimet etnolinguistike të shqipes. Padyshim, kjo në kuadër të grupit të të folmeve verilindore, gjegjësisht të folmeve që shtrihen në territorin e Republikës së Kosovës. Ato qysh herët kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve më në zë të dialektologjisë, të gjuhës shqipe, pastaj të hulumtuesve të onomastikës e të folklorit të pasur që e shquajnë. Përveç kësaj historia dëshmon që në kohët e hershme rëndësinë e këtij rajoni si rrugë kalimtare që ka lidhur brendësinë e Gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Në anën tjetër derisa "Meshari" i Gjon Buzukut është "monument" i kulturës dhe gjuhës shqipe, "Çeta e

¹ M. Domi, "Parathënie", *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, ASHSH, IGJL, V. i I-rë, Napoli, 2007, f. 10.

² Po aty, f. 11.

profetëve” e P. Bogdanit njëjtë shquan arealet e të folmeve të Prizrenit me rrethinë, pra ligjërimin shqip të shekullit të XVII-të në zonën e Prizrenit. Padyshim duke pasur parasysh vlerën e përfaqësimit në letërsinë tonë të vjetër, si:”...të jetë ëndë forë së ndritshmit gjakut së Davidit, 8...”³; /Të lutemi pra, letërrari em i urti, të më ndijesh ndë gjeç falizë qi të trazon veshëtë, përse as dielli pa hije as hana pa niegullazë mbë faqe nuk’ dñshtë. Po vene roe se kush na ka pushtuem e ndë kujët dheë jemi, ani me zemërë anëko’/⁴

Në studimet dialektologjike shqiptare vlerësohen përpjekjet dhe studimet e gjuhës shqipe edhe nga studiuesit e huaj, si: C. Tagliavini, M. Lamberci, N. Jokli, P. Mladenov, etj., të cilët ndihmuan shkencën dhe kulturën shqipe dhe të folmet e këtyre arealeve që po i trajtojmë. Ky rajon ka studime nga rrethi i studiuesve të dialektologjisë së Universitetit të Prishtinës dhe Instituti Albanologjik, të cilët, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore i prinë hulumtimeve që të përimitohet kjo trevë e lashtë para zhvillimeve të reja shoqërore. Këto studime shënuan nxitje në vitet e shtatëdhjeta, që kur u bënë ekspedita të përbashkëta me dialektologë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Shqipërisë me ata të Institutit Albanologjik dhe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës në territorin e Kosovës. Këtu, veçohet doajeni i këtyre studimeve, Akademik Idriz Ajeti, nismëtari i studimeve të mirëfillta, si:”Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit të XIX”; “Zhvillimi historik i së folmes së arbëreshëve të Zarës”, “Mbi gjuhën e “Divanit “ të Sheh Maliqit” etj. Me punime studimore u veçuan: M. Begolli, A. Kelmendi, H. Agani, L. Mulaku⁵, M. Bardhi⁶ etj. Del me shumë interes “Divani” i Sheh Maliqit, një përmbledhje prej 77 këngësh mistike me alfabet turko-arab, i ndikuar nga poezia orientale e kohës. Autori i “Divanit” origjinën e kishte nga katundet e Anadrinit dhe ishte arsimuar në Prizren, ku edhe kishte përvetësuar lëndën dhe traditën islame. Pas Luftës së Dytë Botërore, në vitet e 70-ta dialektologjia u pasurua sa me studime po aq edhe me organizime të ekspeditave kërkimore-shkencore, me ekipe të përbashkëta për vjeljen e materialit gjuhësor e dialektologjik. Kësisoj studimet iu qasen edhe trevave të malësive të largëta për ta pasqyruar gjeografinë gjuhësore të arealeve me interes të përgjithshëm gjuhësor, dialektologjik e onomastik. Përpjekjet do të thellohen edhe me tema të ndryshme të magjistraturave e doktoratave të institucioneve shkencore dhe të Universitetit të Prishtinës. Këtu çmohet ndihma e revistave kulturore e shkencore, si: “Jeta

³ Studime Gjuhësore, I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 26.

⁴I. Rugova, *Vepra e Bogdanit, 1675-1685*, “Rilindja”, Prishtinë, 1982, f. 22.

⁵ H. Agani, *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të Kujunxhiçit*, “Gjurmime albanologjike”, SSHF, Prishtinë, 1968/2, 1969/2.

⁶ M. Bardhi, *Disa veçori karakteristike në vokalizmin e së folmes së Hasit*, PPSHLP, Prishtinë, 1960.

e re”, “Përparimi”, “Jehona”, “Gjurmime albanologjike”, “Gjuha shqipe”, “Dardania Sakra” etj. Pastaj kemi një numër studimesh për arealet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës. Në radhë të parë rajoni i krahinës së Hasit për pasurinë gjuhësore e dialektologjike. Studimet nisin me profesorin M. Bardhi, i cili i qaset veçorive të sistemit zanor: *Disa veçori karakteristike në vokalizmin e së folmes së Hasit*, në revistën “Përmbledhje punimesh” të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës, më 1960. Për këtë anë kemi edhe një numër përshkrimesh për larminë e emërtimeve në toponimi: “Nga leksiku i Hasit të Prizrenit”, “Toponimia e fshatit Mazrek”, “Toponimia e fshatravet Kojush dhe Plane” të botuara si materiale gjuhësore të viseve tona, në numrat e revistës “Gjurmime albanologjike”⁷. Gjithashtu I. Badallaj, pas trajtimeve të ndara të së folmes së këtij areali, të nisur, më 1975, do ta botojë monografinë me titull: “E folmja e Hasit”, Prishtinë. I. Badallaj, me një vështrim do ta përimitojë edhe të folmen e Zhurit, të rrethit të Prizrenit, botuar në “Gjurmime albanologjike” ku spikat veçoritë fonetike, morfologjike e më pak ato sintaksore e leksikore, ndonëse shquan vendbanimin më të madh gati në gjithë Kosovën. Tutje shtrihen viset malore të Malësisë së Vërrinit të Prizrenit dhe kufizohen me të folmen e Opojës, ku A. Zymberi, tërheq vëmendjen pikërisht në “Sistemin foljor të të folmes së fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit”, të cilën e prezanton në SNGjLKSh të mbajtur në Prishtinë, më 1987. Fjala është për format karakteristike të sistemit foljor që i ka në ligjërim e folmja e arealit Shtrungë (Struzhë) të Malësisë së Vërrinit të Prizrenit. Territori i të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij tutje shtrihet në të dy anët e Grykës së Lumbardhit të Malësisë së Epërme të Prizrenit. Këto areale përfshijnë pllajat piktoreske të Rrethit të Bjeshkës së Parkut Nacional Kombëtar të Sharrit, gjegjësisht ngjitjet malore të Prevallës së Prizrenit. Banorët në përdorim e kanë edhe gjuhën shqipe e edhe atë boshnjake si dhe shumë pak atë serbokroate. Nga këndej kemi shembuj për ndikimin e ndërsjellë të shqipes mbi të folmet e këtyre arealeve që kryesisht e kanë në përdorim gjuhën boshnjake si dhe atë serbe, si për shembull: “Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës”⁸. Në lindje të këtyre të folmeve të Grykës së Lumbardhit të Prizrenit vijon Rrethi i Bjeshkës së Kabashit të Prizrenit, të folmen e së cilës ka trajtuar, M. Halimit, “E folmja e Kabashit të Prizrenit”, të botuar në Prishtinë, më 1985. Në këtë vijë të shqyrtimeve, për të folmet e Anadrinit kemi studimin “E folmja e Anadrinit” botuar në Prishtinë⁹. Për sa i përket pikave që pasqyrojnë të folmet e Prizrenit dhe rrethinës së tij në raport me hartat e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe kemi mjaft trajtesa që i kanë shënuar veçoritë si dhe karakteristikat

⁷ A. Zymberi, *Gjurmime albanologjike*, SSHF, V, Prishtinë, 1975, f. 76.

⁸ M. Blaku, *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, 23, “Gjurmime Albanologjike”, Prishtinë, 1993.

⁹ N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2002.

duke i identifikuar edhe proceset historike-gjuhësore e dialektologjike të këtyre të folmeve. Nga trajtimet, zw fill edhe studimi i Z. Krasniqit: "E folmja e elementit katolik të qytetit të Prizrenit", punim i mbrojtur në Fakultetin Filologjik, të Degës së Gjuhës Shqipe të Universitetit të Prishtinës. Më pas në mbështetje të kësaj nisme, punimi i shkallës së magistraturës i Degës së Gjuhës Shqipe të FF të këtij Universiteti: "Veçoritë fonetike të elementit katolik të qytetit të Prizrenit" i V. Topçiu, më 1980. Kemi edhe një numër studimesh të ish profesorit të Shkollës së Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" të Prizrenit, M. Topallit, i cili përveç trajtesave përimituese të lëndës së të folmes së Prizrenit, si: "Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit", u shqua edhe rreth identifikimit të substratit të gjuhës shqipe në kontakt, si: "Substrati i shqipes në turqishten e Prizrenit", të botuar në revistën "Përmbledhje punimesh" të SHLP "Xhevdet Doda" të Prizrenit. Tutje më për së afërmi do të mëtojmë aspektet e pikëtakimeve, gjegjësisht pikëdallimeve të varietetit të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij në krahasim me varietetin standard të gjuhës së sotme shqipe. Për këtë kemi përzgjedhur dy pika që ne kemi menduar se janë edhe më të arsyeshme gjuhësisht për shkak të ndryshimeve e zhvillimeve të fundit. Kështu jemi mbështetur gjithashtu edhe në dy subjekte të përzgjedhur dialektologjikë¹⁰ Në këtë aspekt shquajmë të i referohemi ndryshimit të ligjërimin të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij me variantin standard të gjuhës shqipe, gjegjësisht krahasimit të pikave të përzgjedhura me pikën e parë të ADGJSH-së, si për shembull, fjala *plak* (em. m.) – *plâ:k* (em. f.), *mÿk* (em. m. nj.) – *mÿk* (em. f. nj.) – *a mÿ:k* (f. veta e III), *krÿm* (em.m. nj.) – *A krÿ:m*!¹¹ (f. v. III), *thî:(em.m.)-thî:(em f.)*, *lot* (em. m. nj.)-*lo:t* (em. m. sh.), *hÿj* (em. m. nj.)-*shÿ:j* (fol. III, nj.), *mê:j* (fol. III, nj.)-*mê:ni* (fol. III, sh.):/Mêj mâ: bre!/, /Shÿ:j bre se na lodhe!/, /Mos lÿj mâ:!/ , /Shkova m`i frÿ: fëmisë!/¹²etj.

Në krahasim me variantin e gjuhës së sotme ku nuk kemi as gjatësi e as hundorësi: *plak*, *myk*, *krim*, *thi*, *lot*, *më*, *shuaj*, të folmet e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, ashtu si në varietetin e të folmeve verilindore të gegërishtes si dhe nga i gjithë dialekti i gegërishtes karakterizohen me hundorësi. Është për tu veçuar se sistemi zanor i ligjëtimeve të këtyre të folmeve përbëhet prej gjashtë njësisht fonetike: *â*, *ê*, *ô*, *û*, *î*, *ÿ*. Në këto areale dalin zanore të mirëfillta hundore, ndonëse në ndonjë ligjërim, si në atë të Grykës së Lumbardhit të Prizrenit e kemi më pak të shprehur, zakonisht të

¹⁰Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet; Nikollë Pecollaj, i lindur më 1937, banor i Zymit të Hasit.

¹¹ Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet.

¹² Citimi i sip.

pasuara me bashkëtingëlloret hundore *m*, *n*, *nj*, si për shembull: *nân*, *hâ*, *mâlli*, *sêni*, *hûmi* etj., por ndonjëherë edhe të pa ndjekura, si për shembull: *u frý:*, *kûsi*, *gllî:*, */Shkûn me thý: kollomoçin!/, /Shpejt, thê:ni shtagat?/, /Vëni mirë rô:n?/* etj. Padyshim se këto janë ndryshimet që i pasqyrojnë ligjërimet e këtyre të folmeve në lidhmëri me pikat e ADGJSH-së që spikasin në fillim të pyetësorit (1, 2) për fonetikën. Këto të folme kryesisht dalin me diftongje monofonematike: *di:ll* (*diell*), *lyj* (*lyej*), *bi:(bie)*, */Po ta thej krý:t!/, /Shkoj me lý: sobën./, /Dil me çiru: kollomoçin!/* etj. Përsa i përket bashkëtingëlloreve *q* e *gj*, dukuria është mjaft e lëvizshme, ngase në disa areale këto bashkëtingëllore ruhen, diku kalojnë në *ç* e *xh*. Për pasqyrë më reale të problemit, patjetër se duhet përdorur metodën e eksperimentimit, ndryshe çdo shpjegim mund t'i shpëtojë saktësisë, megjithatë për të folmen e Hasit, I Badallaj thekson: "mendimi ynë, i bazuar në materien e eksploruar në terren është se ekzistojnë një palë okluzivesh palatale-afrikate duke iu afruar më tepër afrikateve e më pak palataleve themelore. Në të folmen e arealit të Kabashit të Bjeshkës së Prizrenit kemi shënuar edhe këta shembuj: */Ka ra n`gj(xh)ak!/, /Euu, paska qa:fë t`tra:shë!/, /Çiti bukë ç(q)ëve?/* etj. Për sa i përket grupeve të bashkëtingëlloreve në ligjërimet e këtyre të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij kryesisht thjeshtëzohen dhe dalin më shumë me elementin e parë, si për shembull: *mjell* (*mbjell*), *kumëll* (*kumbull*), *thum* (*thumbi*), *shkun* (*shkund*), *tun* (*tund*), *knoj* (*këndo*), derisa grupi bashkëtingëllor *ng* shquan një refleks në mes të këtyre dy bashkëtingëlloreve *ng=η*. Në këtë aspekt është për t'u evidentuar se grupi bashkëtingëllor *ngj* del i plotë: *ngjyj* (*ngjyeyj*), *ngjesh*, *ngjall*, njësoj edhe grupet *tj* e *mj*, pastaj ata *pl*, *bl*, e *fl*, si për shembull: *mjekërr*, *mjelt* (*mjaltë*), *plak*, *blej*, *fle* etj. Gjithashtu këtu është për tu theksuar se zanorja *u* e rrokjes së mbyllur fundore në një tip emrash, në rrokje të hapur nuk theksohet, gjegjësisht ajo kalon në zanoren *ë* të fjalës në trajtën e pashquar, si për shembull: *flutër* (*flutur*), *flutra* (*flutura*), *hekër* (*hekuri*), *hekri* (*hekuri*), *vetëll* (*vetull*), *vetlla* (*vetulla*): */Ja dhash do hekra!/, /Mos çit petlla n`ujë!/, /Si i kish vetllat!/* etj. Ndërsa në kuadër të nënndarjes së pyetësorit për dallimet në përbërjen e fonemave të së njëjtës fjalë, apo ndryshethënë të varianteve etimologjike në të folmet e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, gjegjësisht në pikat mbështetëse të këtyre të folmeve kemi vërejtur se ka dallime edhe për sa i përket timbrit edhe për sa i përket nuancave që ka zanorja *ë* e varietetit letrar të gjuhës letrare, si për shembull: *za:* (*zë*), *baj* (*bëj*), *lamë* (*lëmë*), *vej* (*vë*) etj. Po kështu zanorja *y* ka përdorim të rregullt në fjalët: *kryp* (*krip*), *krý:m* (*krimb*), *frikë* (*frikë*) etj. Në pikën 43 të pyetësorit të ADGJSH-së në këto të folme nuk dëgjohet zanorja *o* nistore e varietetit të standardit të gjuhës shqipe të fjalëve, por zanorja e varietetit të variantit të këtyre të folmeve: *aborr* (*oborr*), *axhak* (*oxhak*), *dallap* (*dollap*) etj. Në fjalët që në shqipen letrare ka tog zanor *ua*: *buall* (66/b), *ftua* (67), *duar*, *muaj*, *fyell*, *dyer*, *mësues*, *sulmues* etj., në ligjërimin e këtyre të folmeve përdoren: *bu:ll*,

ftu:, *du:r*, *mu:j*, *fy:ll*, *msus*, *sulmus*: /I kemi pas bijat atkija, se na dalin nipat mushka s`e kemi menu!/¹³, të pikës së 51, 52 dhe 53 të pyetësorit të ADGJSH-së. Fusha e morfologjisë shquan disa pika të pyetësorit për të cilat mendojmë se ka interes për ndryshimin nga varieteti i standardit të gjuhës. Karakteristikë është ruajtja e tri gjinive të sistemit emëror, *kryet, të mirën, të keqen*: /Ta thej kty:t!/, /T`mirën tonë s`ba: me keqpërdor!/. Ndërsa emri në trajtën e shquar të tipave të emrave: *bualli, trualli, fyelli e kërcelli* të pikës së 66-të të pyetësorit të ADGJSH-së, ata e ndryshojnë temën e fjalës, si: *bulli, trulli, fylli, kërcelli*. Në kontekst të përdorimit të gjinisë së emrave: *të ftohtët, të nxehtët, të vjellët*, ka larmi, por mbizotëron gjinia mashkullore: /T`nxe(h)ti madh!/, /T`fto(h)ti madh!/, /Uu po vjella e madhe e kapi!/. Po kështu është edhe me gjininë e emrave: *nder, shëndet, qiell, kryq, lot, dhe qytet* që kryesisht dalin në gjininë mashkullore, por ka edhe raste të përdorimit në gjininë femërore, si: /T`marrrt`shneta mirë!/, /E ka shnetën e mirë!/. etj. Për sa i përket formimit të shumësit të emrave mashkullorë: *ushtar, doktor, dollap, jorgan, kulaç, traktorist*, kemi dallime në raport me varietetin standard të gjuhës, ngase shumësin e formojnë me prapashtesën -t, si: *ushtart, doktorat, dollapat, jorganat, kulaçat, traktoristat*, por edhe: /Ni tepsi kuleq/¹⁴. Po kështu është për t`u evidentuar edhe shumësi i emrave mashkullorë *drapër e gjarpër*, ngase nga të dy pikat mbështetëse të arealeve të të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij kemi edhe ndryshime brendapërbrenda vetë këtyre arealeve e gjithashtu edhe për sa i përket edhe raportit me standardin e gjuhës: *drapni,-t, gjarpni,-t dhe drapna,-t, gjerpna,-t*.¹⁵ Gjithashtu ka mosharmoni në mes të standardit të gjuhës edhe për sa i përket formimit të shumësit të emrave si: *gisht,-a, prift-a, lepur-leprat (lepnat), hamall,-at, kërmij,-at, çakall,-at nxans,-at, mësus,-at* etj. që në varietetin standard të gjuhës shumësin e bëjnë: *gishtërinj, priftërinj, lepuj, hamaj, kërmij, çakaj, nxënës, mësues* etj. Duket se shquan interes dhe ndryshim edhe përdorimi i ndryshëm i shumësit të këtyre emrave mashkullorë në arealet e këtyre të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij: *yll- yjzi* (në të folmen e Hasit: *yjt*), *dash-deshtë, djalë-djelt* (në të folmen e Kabashit të Prizrenit: *djemtë*), *kalë* (185)-*kvajt*, që i referohen pikës së 75, 77, 78, 79, 80 të pyetësorit të ADGJSH-së. Emrat mashkullorë temat e të cilëve mbarojnë me bashkëtingëllore në trajtën e shquar njëjës në rasën kallëzore në të folmet e Prizrenit dhe rrethinës së tij dalin, si për shembull: *mal-malin, zog-zogin, mik-mikin, krah-krahin*, pra jo sipas normës së varietetit të standardit. Kurse sa i përket formave të veçanta rasore kur emrat vijnë pas parafjalëve është me

¹³ Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet.

¹⁴ Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet.

¹⁵ N. Pecollaj, i lindur më 1937, banor i Zymit të Hasit.

interes të veçojmë vetë parafjalën e cila në këto të folme del jo *nën*, por *nër*: *nër gur*, *nër mur*. Në fushën e përemrave nga informatorët tanë kemi shënuar se format e përemrave pronorë kur janë të shoqëruar me emra të farefisnisë, prapa apo pas tyre dalin ndryshe nga variantet letrare, si për shembull: *biri jem* (*biri im*), *bija jeme* (*bija ime*), po kështu në rasat emërore, dhanore dhe kallëzore, përemri pronor im kur vjen pas një emri në këto të folme të arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës del: *kalit tem* (*kalit tim*), *kali jem* (*kali im*). Ndryshim kemi shënuar edhe te format rasore të përemrit pronor *ynë*, kur vjen pas një emri, si: *kali jonë* (*kali ynë*), kryesisht të pasqyruara në pikat 95, 96, 97 e 99-të të pyetësorit të ADGJSH-së. Një veçori tjetër dalluese në mes të dialekteve të shqipes është koha e pakryer e mënyrës dëftore. Kjo është karakteristikë edhe për sistemin e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës, por edhe për të folmet e grupit verilindor të të folmeve të gegërishtes si dhe me trajtat që pasqyrohen në këto ligjërime. Në arealin e këtyre të folmeve përdoren format sigmatike me *-sh*, si: *-(j)sha*, *-(j)she*, *-(j)ke*; *-(j)shëm*, *-(j)shim*, *-(j)shum*, *-(j)shi(t)*, *-(j)shin*, për foljet që mbarojnë me temë në zanore, gjegjësisht pa fonemën *j* për trajtat foljore që dalin me temë në bashkëtingëllore, si: *lajsha*, *lajshna*, *prejsha*, *prejshna*, *lypshta*, *ecsha* etj. /Kur punojshmi na bereqeti u bajke i mirë!/, /Punojshmi shumë, milshmi, vaditshmi, kositshmi, krejt bashkas, s'kish çare pa u ba:!/ /Kur u zdjergshmi poshtë, thirrshmi argat./, /E mihshmi kollomoçin, shati i parë./ /Manëj, pas dy jave, e mushmi kallamoçin, shati i dytë./, /Masi i kryjshim punët e pran' verës u ngjitshmi n'bjeshkë./, /Kur dalshmi nëbjeshkë u gzoshmi shumë a?//Ni vjet, s'e maj men se cili vjet ishte, kur kum pas dal un i pari në bjeshkë ka pas shumë egërsi!// Vjeshtës u zdjergshmi./¹⁶ Çështja e veçorive sintaksore në studimet e autorëve është marrë në shqyrtim, por edhe jo në masë të duhur, ngase në këtë drejtim sa veç janë emërtuar disa veçori dalluese a tipare të përbashkëta, në këtë kuptim edhe për të folmet e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Prandaj për dialektologjinë shqiptare në përgjithësi si dhe për dialektologjinë kosovare në veçanti, pra në këtë hulli edhe të këtyre ligjërimeve që i kemi në shqyrtim edhe mbetet me interes pasqyrimi më i përpiktë i veçorive në këtë fushë. Ndërsa për sa i përket çështjeve sintaksore që janë shtruar në kuadër të pyetësorit të ADGJSH-së, në të nëntë pyetjet (137-145), del dallimi më i madh me varietetin e standardit të gjuhës së sotme, përdorimi i formave të paskajores në vend të atyre të formave të lidhore sidomos në fjalitë pyetëse të drejta me ndajfolje dhe përemra të këtyre, si: *ku*, *kur*, *si*, *qysh*, *pse*, *me se*, *kë*, *kujt*, *sa*, si: *-ku të shkoj?* - *ku me shku?*; *-qysh të bëj?* - *qysh me bë?*; *-sa të rri?* - *sa me nëjt?* etj. Gjithashtu edhe për sa i përket ndërtimeve hipotetike të përbëra nga togjet foljore, elementi i parë i së cilës shpreh fillim veprimi, në

¹⁶ Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet.

këto pika mbështetëse si dhe në arealet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, përdoren format e paskajores në vend të formave lidhore, si për shembull:- *filloi të pijë- filloi me pi; -nisi të këndojë-nisi me knu; -zu të kërkujë-zu me kërkuj* etj. Edhe për sa i përket pikave të tjera që shquajnë parafjalët, parapëlqehen të përdoren parafjalët *prej, përtej*, më rrallë *matanë* dhe ndoshta shumë rrallë *tej: Tej gardhit.* etj. Ndërsa në fushë të leksikut për sa i përket arealeve të këtyre të folmeve si dhe pikave mbështetëse që kemi përzgjedhur për ta prezantuar sa më denjësisht të folmen e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, duhet të shtojmë se pasqyrojnë thesar të çmuar që edhe vetë e ka identifikuar gjuhën dhe kulturën shqipe që në kohët e moçme të zhvillimit të saj. Këtu, padyshim se e kemi fjalën për shtresën leksikore të parashqipes, të shtresës indoevropiane të saj, ndryshe thënë edhe të vetë mbiekzistencës së saj, pjesë e së cilës është edhe trualli i këtij mjedisi autokton fjalësor i këtyre të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Kjo trashëgimi e pasur e me vlera të pamohueshme të njësive leksikore e frazeologjike u mblodh dhe u sistemua në shërbim të ndërtimit të “shenjëtores” sonë kombëtare, gjuhës sonë, Gjuhës Shqipe. Punë kjo e cila po vazhdon edhe sot, anekënd shqipfoljes, si dhe me vetë ADGJSH-në, përkatësisht edhe me pyetësin e kësaj “kurore” të së sotmes shqipe. Në këtë hulli të përimitit, radhitja e (405-146= [259]) dyqind e pesëdhjetë e nëntë njësive leksikore e shteron edhe më larminë dhe pasurinë e interpretimit sa më shprehës e më të çiltër të gjuhës dhe varianteve që e përbëjnë gjithë thesarin përmbajtësor të saj. Meqenëse do të ishte e pamundshme që në këtë trajtesë të u referohemi të gjitha këtyre njësive leksikore, aq më tepër pasqyrimin edhe me shembuj që do ta reflektonin dëshminë e interpretimit, qoftë nga pikat mbështetëse të përzgjedhura, gjegjësisht nga të folmet që i kemi objekt të trajtimit tonë. Në pikën 146-të, daljes së diellit, që në variantin standard është: lind, në këto të folme përdoret: */Ka le dilli./*, ndërsa për perëndimin e diellit: */Ka praru dilli/*. Ndërsa për fjalën (149) VES/Ë-A, përdoret edhe *lagshti, -a*¹⁷; për fjalën (159) FERR/Ë-A, forma: *therr-a*, derisa BOÇË MISRI (163), në të folmen e Kabashit të Prizrenit përdoret: *tallë, -a* (Pjesa e mbetur pas heqjes së kokrrave të misrit). Kurse një lloj kërpudhe me pluhur të zi që e *vesh* kallirin e grurit, të elbit etj. KLLOGJ/ËR-RA(165), në këto të folme e shquajnë me këtë emër: Unth,-i (Uth,-i). Në këtë aspekt shtojmë vetëm për laryshinë e emërtimeve të zogjve, si për shembull: TURREC-I: /Zog që vjen në pranëverë dhe knon turr-turr, vjen me qyqen e shkon gati nëgjysmë tëpranverës!;/ LORËZ,-A: /Shpend i madh gati sa turreci dhe knon: hej-haj-haj-hej..., gati si

¹⁷ Brahim (Selim) Kukaj, i lindur më 1929, në Muzhlak (Mushlak), banor i Korishës së Prizrenit, bujk fare i padalë në kurbet.

njeri!;/ TRINC-I: / Zog shumë i vogël;/ GRIZË,-A: /Një lloj fllanze e malit, gati si p`llumb mali!/ etj.¹⁸

Në vijim po i evidentojmë një numër shembujsh që janë më karakteristikë, të cilët takohen me varietetin e standardit të gjuhës, pastaj një numër tjetër shembujsh që dallojnë sa brendapërbrenda të folmeve që po i trajtojmë, gjithashtu edhe në mes të folmeve që veçojnë dhe pasqyrojnë autenticitetin e arealit të të folmes që i takojnë:

VES/Ë-A - ...lagësirë e hollë që bie mbi gjethe e bar gjatë natës në pranverë e vjeshtë...më rrallë dëgjohet: BRYMË-A, e shumë më rrallë:VESE-A, /Natën bje LASHTË më shumë/, LASHTA ia nis para akshamit./, Kur bje LASHTA prite shiun/.....LASHTËA

SYTH-I - ... një e fryrë në majë ose në anë të degës së drurit, nga e cila dalin gjethet në pranverë,/Kanë mërthy pemët/, /Ka nis mulli (syni) i pemës/.....MU(G)LL-I

ZGAV/ËR-Ra - ...e gërryera e madhe në trungun e ndonjë peme të vjetër:/ZGURI në dru!, Ish kanë lisi i ZGURAFTE!/.....ZGUR-I

FERR/Ë-A - bimë me gjemba që rritet në gjerdhe e që bën kokrra të zeza ...TERRË-A

GOMAR-I ...kafsha për të bartur, më e vogël se kali dhe me veshë të gjatëMAGAR-I

QENGJI-I ...i vogli i deles, b) shumë të këtitë quhen.....KINGJ-A

RRUR/ËZ-ZA ...i vogli i deles kur bëhet një-dy vjeç (femër).[SHELEG (m.)RRUNZË-A

MILOR-I ...i vogli i deles kur bëhet një-dy vjeç (mashkull)PJELLAK-I

ROGUSH/Ë-A ...dele me brirë.....[GOSH-I (m.)], GOSHË-A

CJAP-I.....mashkulli i dhisë quhet:.....[SJEP-TË (sh.)]SJAP-I

KEC-I ... i vogli i dhisë deri në një vitEDH-I

FTUJ/Ë-A ...i vogli i dhisë kur bëhet një-dy vjeç (femër)FTUJË-A

FTUJAK-U ...i vogli i dhisë kur bëhet një-dy vjeç (mashkull)FTUJAK-U

SHYT/Ë-A ...dhi pa brirëSHYTË-E

QUKAPIK-U zog me sqep të fortë,që çukit në lëvoret e drurëve për të nxjerrë krimba; Që i mëshon shpejt vendit në dru!/, /Tëk, tëk, tëk, tëkëëërrrr, tëkëërrr!

..... PIKTH-I

BUF-I ...shpend grabitqar i natës, me kokë të madhe, me sy të mëdhenj, me sqep të shkurtër e të kthyerHUT-I

KUKUVAJK/Ë-A ...zog grabitqar i natës, që ushqehet me zogj e me minj dhe këndon me një zë sikur vajtonQYQE-JA

QOKTH-I ...zog që cicëron natën qok-qok; /Një zog që knon para Shingjergjit!/QOKTH-I

GJEL-I ...mashkulli i pulësKNUS-I

¹⁸ Subjekt i cituar, më lart.

KLLUK/Ë-A pula kur bie për zogj e gjatë kohës që i rrit. KLLOÇKË-Ah
.....KLLUÇKË-A
ZEKTH-I ...një lloj mize e madhe që u ngjitet lopëve, i pickon dhe u thith gjakun
.....XEKËRR-I
ARËZ-A ...insekt sa bleta, me ngjyrë kafe të hapët; rron në plasat e dhomave, të
orendive të shtëpisë dhe u thith gjakun njerëzve kur flenëGREJZË-A
XIXËLLONJ/Ë-A insekt i vogël, që gjatë natës lëshon ndriçon si shkëndijë
....BUKARE-JA
DJALË-I -Kur gruaja lind mashkull, thonë lindi.....DJEL-I(Has.); ... DJALË-I
VAJZ/Ë-A -Kur gruaja lind femër, thonë lindiQIKË-A
SHKUES-I ...ai që ndërmjetëson për t'u bërë një fejesëMSIT-I
BINJAK-U, BINJAK/E-JA ...njëri nga dy vëllezërit ose njëra nga dy motrat që
lindin njëherëshBINEQ (Shum.); BINAK-U, BINJAKE-JA
KOK/Ë-A ...pjesa e sipërme e trupit të njeriut, që qëndron mbi qafëKRY-E
KËMBALEC-I ...mjet hekuri me tri këmbë, që vihet në zjarr për të vendosur mbi
të një tenxhere, tepsi, gjym, etj.SAGJAJAK-I
SHKAPRA-T ...degë të holla e të thata, që përdoren për të ndezur zjarrin
SPIRRA-T
QETH-I mjet druri në formë të rrumbullakët, në të cilin tëhollin petë..TANUR-I
(Has);.....FUN-I
PETËS-I ...shkop i hollë që përdorim për t'holluar petë:OTLLAGI-JA(Has);
...T`HOLLOJS-A
AJKË-A ...cipa që vë qumështi pasi rri disa orë në një vend të freskët ose kur zien
...MAZË-A
RRËND-I ... fara e djathit që nxirret nga mullëza e qengjit ose e kecit
....MULLËZ-A
TUNDËS-I ...enë druri, me të cilën rrihet qumështiT`PI-T`PINI
SHKOPI I TUNDËSIT. shkopi që përdoret për të rrahur qumështin
.....SHTAGA E TUNDSIT
GUN/Ë-A ...veshje e sipërme prej shajaku, që mbajnë zakonisht barinjët për t'u
mbrojtur nga shiu e nga të ftohtitGUJË-A
VATH/Ë-A ...vend i rrethuar me gardh, ku rrinë bagëtitë gjatë verës
..TORISHTË-A
SHTRUNG/Ë-A.....shtegu i deleve ku kalojnë për t'i mjelëSHTRUNG/Ë-A
LAS/Ë-A ...përdorëse prej druri që shërben për të rrahur teshat gjatë larjes
.....PARAJK/Ë-A
ZGJEDH/Ë-A (pjesët e saj) ... pjesa e parmendës ku mbrehen qetëZHEGËR-A
TYK/Ë-A ... pjesa e prapme e sëpatësQYKË-A
KRËHËR-I (leshi) ...mjet me dhëmbë hekuri, që përdoret për të krehur leshin
.....KËRHAJ-A
FËNYELL-I ...vegël e këpucarit, me bisht druri e një majë hekuri të ngulur, që
shërben për të hapur vrima në shollë:/Mjet me të cilin ia bën vendin gjylpanës e
pastaj e shtin atë!/:.....FEMËZ-A

SHKRIF (lesh) ...hap me dorë leshin që mos të jetë i ngjeshur, në mënyrë që të kalojë lehtësisht nëpër krehër.....KËRHAJ LESHIN
KREH ...shkrif leshin më krehër KËRHNUR-I
SHAJAK-U stof i leshtë i bërë në avlëmend e i shkelur në dërstilë ..ZHGUNË-A
LYRA E LESHIT ...lëngu i papastër që del kur lahet leshiAJKË-A
MBRETËRESH/Ë-A ...bleta më e madhe, ajo që drejton gjithë bletët e tjera
.....AMË-A
ÇARK-U ...mjet, zakonisht prej hekurit,që e ngrehim për të zënë gjah. KURTH-I
SQEPAR-I ...vegël që përdoret për të gdhendur drurin, kryesisht bishta për mjete.....HJEKËS-I
BËRXHIK-U ...gjatësia nga maja e gishtit të madh deri te maja e gishtit tregues
....PIQIK-U
MËNGJES¹⁹ ...-(Kohë e ditës)...koha e fillimit të ditës, pak para dhe pas lindjes së diellit(SABAH), N`AD`JE

¹⁹ Vepër e cituar .